

**Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete**

**Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik**

**Çështjet lidhur me rolin e bashkëpunëtorëve  
profesional dhe inicimin e procedurave në rastet e  
trashëgimisë**

**Edicioni 9  
Nëntor 2010**

## Përmbledhje Ekzekutive

Kur gjykatat në Kosovë dështojnë të zhvillojnë procedurat trashëgimore në pajtim me ligjin, të drejtat e individëve siç garantohen me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, mund të mos mbrohen në mënyrë adekuate. Në veçanti, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE), kanë vërejtur se procedurat trashëgimore nuk zhvillohen gjithmonë nga gjykata e themeluar sipas ligjit. Veç kësaj, procedurat trashëgimore nuk iniciohen në përputhje me procedurën e paraparë me kornizën legjislative. Përderisa ka shumë faktorë që mund të ndikojnë në shqyrtimin e duhur të një procedure trashëgimore, OSBE ka zgjedhur që në këtë raport të shqyrtojë vetëm këto dy mangësi thelbësore procedurale. Raporti përfundon me rekomandime se si të trajtohen mangësitë e identifikuara.

## Hyrje

OSBE është e brengosur se disa procedura trashëgimore në gjykata në Kosovë janë duke u trajtuar në atë mënyrë që mund të shkelin si ligjin vendor ashtu edhe atë ndërkombëtar. Mungesa e qartësisë në kornizën ligjore e cila rregullon kryerjen e këtyre procedurave dhe komunikimi i dobët ndërmjet autoriteteve komunale dhe atyre gjyqësore, në masë të madhe dëmtojnë përpjekjet e gjykatave për t'i zhvilluar procedurat trashëgimore në pajtim me legjislacionin përkatës. Në disa gjykata komunale, procedurat trashëgimore zhvillohen nga bashkëpunëtori profesional në vend se nga gjyqtari, edhe pse ligji nuk e parasheh këtë mundësi. Procedura e paraparë për iniciimin e shqyrtimit të trashëgimisë, në praktikë pothuajse kurrë nuk përcjellët.

Gjykatat në Kosovë rrezikojnë të shkelin si standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ashtu edhe ligjin vendor, kur dështojnë t'i zhvillojnë procedurat e trashëgimisë në pajtim me kornizën përkatëse normative. Në veçanti, Nenet 6 dhe 8, dhe Neni 1, Protokollu 1 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale (KEDNJ)<sup>1</sup> dhe përshkrimi përkatës i këtyre të drejtave në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) janë të përfshira në zhvillimin e këtyre procedurave. Nenet 15 dhe 16 të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, po ashtu janë relevante.<sup>2</sup> Sipas ligjit vendor, shqyrtimi i pronës trashëguese duhet të zhvillohet në bazë të Neneve 125-189 të ligjit mbi procedurën jo-kontestimore (LPJK).<sup>3</sup> Ligji për trashëgiminë i cili hyri në fuqi

<sup>1</sup> Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Fundamentale (KEDNJ), Neni 6 parasheh se “[n]ë përcaktimin e [. . .] e detyrimeve dhe të drejtave civile [. . .] çdo kush ka të drejtën për dëgjim publik dhe të korrekt brenda kohës së arsyeshme nga gjykata e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj.” Neni 8 KEDNJ garanton, *inter alia*, “të drejtën për respektimin e [. . .] e jetës private dhe familjare.” Jurisprudenca e GjEDNJ-së ka njohur të drejtat e trashëgimisë në mungesë të testamentit të bien në sferën e Nenet 8. Shih *Marckx kundër Belgjikës*, GjEDNJ, aktgjykimi i 13 qershorit 1979. Neni 1, Protokollu 1 garanton të drejtën për “gëzimin e patrazuar të [. . .] posedimeve.” Koncepti i posedimeve “ka një kuptim autonom i cili nuk është i kufizuar në pronësi të të mirave fizike dhe është i pavarur nga klasifikimi formal në ligjin vendor: disa të drejta tjera të caktuara që përbëjnë asetë po ashtu mund të konsiderohen si ‘të drejta pronësore’ andaj si të tilla edhe ‘posedime’[.]” *Beyeler kundër Italisë*, Dhoma e Lartë e GjEDNJ-së, aktgjykim i 5 janarit 2000, paragrafi 100.

<sup>2</sup> Shih Konventën për Eliminimin e çdo Forme të Diskriminimit Kundër Grave. Neni 15 u jep grave, *inter alia*, “barazi me meshkuj para ligjit.” Neni 16 kërkon eliminimin e diskriminimit kundër grave “në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe marrëdhëniet familjare,” dhe në veçanti, kërkon nga autoritetet që të sigurojnë, *inter alia*, “të drejtat e njëjta për dy bashkëshortët në kuptim të pronësisë, përvetësimin, menaxhimin, administrimin, gëzimin dhe disponimin me pronë [. . .].”

<sup>3</sup> Ligji mbi Procedurën Jokontestimore, Nr. 03/L-007, 13 dhjetor 2008, të cilën gjykatat në Kosovë kanë filluar ta zbatojnë me 28 janar 2009. Shih po ashtu Ligjin mbi Procedurën Jokontestimore, Nr.

në vitin 2005, edhe pse i pari në kohë, vepron si *lex specialis* për çështjen lëndore. Prona e trashëgimlënësit mund të bartet përmes procedurës trashëgimore ose bazuar në ligj (vdekje në mungesë testamenti) ose bazuar në testament.<sup>4</sup> Në shumicën e procedurave të trashëgimisë të monitoruara nga OSBE, prona është bartur në bazë të mungesës së testamentit.

### ***Gjykata e themeluar me ligj***

Neni 6(1) i KEDNJ-së garanton të drejtën për “gjykatë të themeluar me ligj.” Në mënyrë që të përmbushen kushtet e kësaj të drejte, gjykata duhet të funksionojë në pajtim me mënyrat e specifikuar nga e drejta përkatëse lëndore dhe procedurale.<sup>5</sup>

Si LPJK ashtu edhe ligji për trashëgiminë rregullojnë mënyrën sipas të cilës duhet të zhvillohen procedurat trashëgimore. Neni 145 i ligjit për trashëgiminë parasheh se: “[r]regullat e procedurës sipas të cilave, gjykata, organet e tjera dhe personat e autorizuar veprojnë në çështjet e trashëgimisë përcaktohen me dispozitat për procedurën jashtëkontestimore.” LPJK parasheh se “shqyrtimi i pasurisë trashëgimore bëhet në seancë gjyqësore”<sup>6</sup> Deklarimet e palëve lidhur me pronën e trashëguar mund të parashtrihen ose me shkrim, në cilin rast duhen të jenë të nënshkruara nga pala, ose si alternativë të jepen gojarisht pranë gjykatës kompetente.<sup>7</sup> Sipas Nenit 131: “[m]arrjen e provave dhe të deklaratave për heqjen dorë nga trashëgimia e bënë gjykatësi bashkë me procesmbajtësin. Deklaratat e tjera dhe propozimet e pjesëmarrësve në procedurë mund t’i marrin në procesverbal edhe bashkëpunëtorët profesional.”<sup>8</sup>

Andaj, duket se ligji parasheh se gjyqtari duhet të jetë i pranishëm kur pala deklaron se po tërhiqet nga prona e trashëguar. Megjithatë, nuk është e qartë se si mund të dijë gjykata, para seancës dëgjimore se a do të tërhiqen apo jo palët që do të marrin pjesë në seancë. As nuk është e qartë se “marr[ja] në procesverbal”<sup>9</sup> a i referohet vetëm përpilimit të procesverbalit të shkruar, apo i referohet procedurës gjyqësore ku palët do të dëgjojnë dhe propozimet do të vlerësohen para gjyqtarit. Kjo mungesë e qartësisë është faktor në shumëllojshmërinë e praktikave gjyqësore që OSBE ka vërejtur gjatë procedimit të rasteve të trashëgimisë, nga ana e gjykatave në Kosovë. Në disa gjykata komunale procedurat trashëgimore zhvillohen vetëm nga bashkëpunëtorët profesional. Për shembull:

Në gjykatat komunale e tri, nga pesë rajonet, OSBE vërejtë se në rastet jo-kontestimore të trashëgimisë, bashkëpunëtori profesional ka caktuar seancat, ka zhvilluar procedurën e provave, ka marrë deklaratat për tërheqje, ka pranuar propozimet e pjesëmarrësve dhe i ka dërguar palëve aktvendimet, të tërat vet ai apo ajo. Përkundër faktit së asnjë gjyqtar nuk ishte ndonjëherë në ndonjë seancë, në procesverbalet e seancave gjyqësore thuhej se kryetari i gjykatës ishte i

---

42/1986 Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Në linjë me praktikën e zakonshme, ky raport, për versionin në gjuhën angleze i referohet ‘Law On Out Contentious Procedure’ si ‘Law on Non Contested Procedure’ (LNCP).

<sup>4</sup> Shih Nenin 1(2), Ligji për Trashëgiminë, Nr. 2004/26 i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2005/7, 4 shkurt 2005.

<sup>5</sup> Shih *Zand kundër Austrisë*, Aplikacioni Nr. 7360/76, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, 12 tetor 1978, paragrafi 71.

<sup>6</sup> Neni 159 (1), LPJK.

<sup>7</sup> Nenet 163, 164 dhe 165, LPJK.

<sup>8</sup> Neni 131, LPJK.

<sup>9</sup> Ibid.

pranishëm si gjyqtar dhe se aktvendimet ishin lëshuar në emër të kryetarit të gjykatës si gjyqtar.

Edhe pse bashkëpunëtorët profesional shpesh kryejnë detyrat e tyre me një nivel të lartë të kompetencës, fakti se korniza ligjore nuk i autorizon ata t'i zhvillojnë procedurat trashëgimore vetëm, do të thotë që ata nuk do të duhej ta bënin këtë. Sipas kornizës ligjore, prej gjyqtarëve kërkohet që t'i përmbahen kritereve më të rrepta, se sa bashkëpunëtorët profesional. Është përgjegjësi e kryetarëve të gjykatave ta organizojnë punën brenda gjykatës në atë mënyrë që procedurat trashëgimore të mund të zhvillohen nga gjyqtari, siç është e paraparë me ligj.

### ***Inicimi i Procedurave***

Ligji për trashëgiminë thotë “[m]e vdekjen e personit hapet trashëgimi i tij.”<sup>10</sup> LPJK parasheh “[p]rocedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore vihet në veprim nga gjykata sipas detyrës zyrtare posa gjykata të informohet se një person ka vdekur ose është shpallur i vdekur me vendim gjyqësor.”<sup>11</sup> Veç kësaj, “[k]ur një person vdes ose shpallet i vdekur me vendim gjyqësor, organi komunal i shërbimit kompetent për mbajtjen e librit amzë të vdekjeve ka për detyrë që, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita në të cilën e ka regjistruar vdekjen, t’ia dërgojë aktvdekjen gjykatës [...]”<sup>12</sup>

Përkundër procedurës së paraparë me ligj, në praktikë nuk ka një sistem të tillë. OSBE ka vërejtur se shumë gjykata komunale nuk marrin njoftimet për vdekje nga autoritetet komunale.<sup>13</sup> Në vend të kësaj, gjykatat në mënyrë tipike, iniciojnë procedurat trashëgimore vetëm pas parashtrimit të propozimeve nga palët. Shpesh këto propozime nuk bëhen deri shumë vite pas vdekjes së trashëgimlënës. Më poshtë janë dhënë vetëm disa shembuj nga rastet e monitoruara nga OSBE.

Në një gjykatë komunale në rajonin e Gjilan/Gnjilane, me 21 qershor 2010, një palë parashtroi propozim për inicim e procedurës trashëgimore për një trashëgimlënës i cili kishte vdekur në vitin 1979. Nga koha kur ishte iniciuar procedura, dy trashëgimtarë potencial të rangut të parë veçse kishin vdekur.

Në një gjykatë komunale në rajonin e Prizrenit, me 9 qershor 2010, një palë parashtroi propozimin me të cilin kërkonte inicimin e procedurës trashëgimore për një trashëgimlënës i cili kishte vdekur në vitin 1980.

Në një gjykatë komunale në rajonin e Pejë/Peć, me 28 dhjetor 2009, pala parashtroi propozim me të cilin kërkonte inicimin e procedurës trashëgimore për një trashëgimlënës i cili kishte vdekur në vitin 1984.

---

<sup>10</sup> Neni 124(1), Ligji për Trashëgiminë.

<sup>11</sup> Neni 127, LPJK.

<sup>12</sup> Neni 133 (1), LPJK. Neni 66 i LPJK-së , obligon gjykatat të marrin vendimin e formës së prerë mbi vdekjen e personit të zhdukur dhe të ja dërgojnë vendimin e tillë, *inter alia*, “[...]gjykatës kompetente për zhvillimin e procedurës trashëgimore.” Sa i përket “Librit amzë të të vdekurve” dhe personave apo autoriteteve që duhen të prezantojnë “faktit të vdekjes” shih Nenet 33-37, Ligji Nr. 2004/46, Për Librat Amzë, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2005/21 me 7 maj 2005 dhe pjesërisht e ndryshuar përmes Rregullores së UNMIK-ut 2008/25 me 16 maj 2008.

<sup>13</sup> OSBE ka vërejtur se ato autoritete komunale të cilat i dërgojnë gjykatës njoftimin, këtë e bëjnë vetëm me kërkesë të palëve të interesuara në inicimin e procedurës trashëgimore. OSBE nuk ka monitoruar ndonjë rast të procedurës trashëgimore që kishte të bënte me person të zhdukur i cili ishte shpallur i vdekur përmes vendimit të gjykatës.

Në një gjykatë komunale në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica, me 5 gusht 2010, pala parashtrori një propozim me të cilin kërkonte iniciimin e procedurës trashëgimore për një trashëgimlënës që kishte vdekur në vitin 1987.

Në një gjykatë komunale në rajonin e Prishtinë/Priština, me 15 mars 2009, pala parashtrori një propozim me të cilin kërkonte iniciimin e procedurës trashëgimore për një trashëgimlënës i cili kishte vdekur në vitin 1988.

Vonesat në iniciimin e procedurave trashëgimore pas vdekjes, kanë pasoja të mundshme negative. Së pari, derisa nuk ka *per se* ndonjë parashkrim ligjor për të kërkuar trashëgiminë, të drejtat trashëgimore *vis-à-vis bona fide* dhe *male fide* parashkruhen brenda dhjetë dhe njëzet viteve respektivisht.<sup>14</sup> Së dyti, kur një procedurë trashëgimore nuk kryhet deri shumë vite pas vdekjes së trashëgimlënësit, trashëgimtarët potencial të rangut të parë mund të vdesin në ndërkohë. Këta trashëgimtarë potencial të rangut të parë janë të privuar nga mundësia për të gëzuar përparësitë potenciale të të qenit titullar i pronës së paluajtshme. Së treti, efekti i dështimit për të kryer procedurat trashëgimore do të thotë që personi i vdekur mund të mbetet titullar i pronës së paluajtshme për periudha të gjata kohore. Kjo situatë mund të inkurajojë transaksione pronësore joformale (të paligjshme) dhe dëmton mundësinë e trashëgimtarëve potencial për ta tjetërsuar pronën e paluajtshme në mënyrë ligjore. Veç kësaj, kredia nuk mund të nxjerrët nga prona e paluajtshme, titulli në të cilën nuk është i qasshëm. Në vend të kësaj, fuqitë ekonomike qëndrojnë me ata të cilët ushtrojnë kontroll faktik mbi pronën e paluajtshme dhe të cilët mund të kenë interes legjitim ligjor, pasi që trashëgimtarët janë privuar nga mundësia për të vendosur se a do të ushtrojnë të drejtat e tyre sipas ligjit.

## **Rekomandime**

### **Për Kuvendin e Kosovës:**

- Të marr parasysh ndryshimin e ligjit mbi procedurën jo-kontestimore për të përcaktuar më qartë rolin përkatës të gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional.
- Të marr parasysh ndryshimin e ligjit për trashëgiminë për ta sjellë atë në përputhshmëri me praktikën që sot mbizotëron në Kosovë për iniciimin e procedurës trashëgimore, veçanërisht pengesat për referim me kohë të rasteve pranë gjykatave.

### **Për institucionet komunale:**

- Të ndërmarrin hapa për të sjellë praktikën komunale në fushën e procedurave trashëgimore në përputhje me kushtet nga ligji vendor.

### **Për gjykatat:**

- Të sigurojnë që të gjitha procedurat trashëgimore e ngritura pranë gjykatave, të gjykohen nga gjyqtarët siç parashihet me ligjin vendor, e jo nga bashkëpunëtorët profesional.

---

<sup>14</sup> Neni 138, Ligji për trashëgiminë.

**Për Institutin Gjyqësor të Kosovës:**

- Të vazhdojë të trajnojë gjyqtarët lidhur me procedurat trashëgimore dhe implikimet e tyre me të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit; të merr parasysh ofrimin e këtyre trajnimeve edhe për bashkëpunëtorët profesional.